
RREGULLORE NR. 2001/40

**NDRYSHIMI I RREGULLORES SË UNMIKU-ut NR. 2000/29 MBI THEMELIMIN E
TATIMIT TË PARAGJYKUAR**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për Kosovën të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999 mbi Autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe nenin 8.1(ç) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/9 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese të Qeverisjes së Përkohshme në Kosovë,

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/29 të datës 20 maj 2000 mbi Tatimin e paragjykuar,

Me qëllim të lehtësimit të zbatimit të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/29 për përfundimin e konvertimit nga marka gjermane ("DM") në euro,

Me anë të kësaj shpall sa vijon:

Neni 1

Ndryshimet e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/29 mbi Themelimin e
tatimit të paragjykuar

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/29 do të ndryshohet si më poshtë:

- (a) Në nenin 1 (c) "15.000 DEM" do të zëvendësohet me "7.500 euro";
- (b) Në nenin 3.2(ç), "2.500 DEM" do të zëvendësohet me "1.250 euro";
- (c) Në nenet 4.2 dhe 6.2, "15.000 DEM" do të zëvendësohet me "7.500 euro" dhe
- (ç) Në shtojcën A, kudo që të paraqitet:

- (i) “400 DEM” do të zëvendësohet me “200” euro;
- (ii) “300 DEM” do të zëvendësohet me “150 euro”;
- (iii) “200 DEM” do të zëvendësohet me “100 euro”
- (iv) “250 DEM” do të zëvendësohet me “125 euro”;
- (v) “150 DEM” do të zëvendësohet me “75 euro” dhe
- (vi) “75 DEM” do të zëvendësohet me “37.50 euro”.

Neni 2
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 3
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 4
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2002.

Hans Haekkerup,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm